



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 14/12/2020

Nga: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrëçimit Publik.

Drejtuar: Operatorit ekonomik “**Gentian Sadiku**” p.f, me NUIS L42314005A, me adresë: Rruga “Tom Plezha”, Pallati Milo, Nr 7, Yzberisht, Kashar, Tiranë.

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozim.

Numri i referencës së procedurës: REF-69120-08-19-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje uniforma dhe veshje të tjera speciale”, afati: 30 (tridhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.59, Datë 24.08.2020.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “**MALBERTEX**” sh.p.k, me NUIS K71821009N, me ofertë **4.910.300** (katër milion e nëntëqind e dhjetë mijë e treqind) leke pa TVSH.
2. Operatori ekonomik “**Gentian Sadiku**” p.f, me NUIS L42314005A, me ofertë **5.478.300** (pesë milion e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind) leke pa TVSH

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “**MALBERTEX**” sh.p.k, me NUIS K71821009N

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku parashikohet se “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallrat objekt prokurimi katalog dhe / ose skedë teknike, në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e specifikimeve teknike të mallrave të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara nga AK.*”

Operatori ekonomik “Malbertex” sh.p.k ka paraqitur autorizim distributori nga shoqëria “Safety Albania” sh.p.k, e cila deklaron se është distributor zyrtar i kompanive prodhuese si:

- CERVA GROUP A.S
- IGES IS GUVENLIGI EKIPMANLARI SAN.VE.TIC.LTD.STI
- BLN ENDUSTRI SANAYI VE TICARET LIMITED SIRKETI

Shoqëria “Safety Albania” sh.p.k autorizon shoqërinë “Malbertex” sh.p.k që të paraqesë ofertë teknike dhe financiare në këtë procedurë prokurimi për mallrat që janë prodhuar nga prodhuesit e sipërcituar si mëposhtë vijon:

- 1 Këpucë pune me qafë
- 2 Këpucë antistatike (antishock)
- 3 Çizme pune
- 4 Kominoshe të gomuara
- 5 Kaskë mbrojtëse
- 6 Maskë respiratore
- 7 Doreza pune
- 8 Doreza pune izoluese tensioni Latex (Për elektrikist)
- 9 Doreza pune nitrile (Për elektrikist)
- 10 Gjunjëza
- 11 Syze sigurie pune
- 12 Syze saldimi
- 13 Ndriçues koke
- 14 Tapet sigurie antishock
- 15 Shalore dhe rrip sigurie

Për mallrat e tjerë, objekt prokurimi siç janë jelekët, xhupi I punës, bluza, pelerina, maska, canta, kutia e ndihmës së shpejtë dhe brezore, operatori ekonomik “Malbertex” deklaroi se është prodhues dhe i ka prodhuar vetë.

Nga verifikimi i dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “Malbertex” rezultoi se ky i fundit ka paraqitur një katalog, të cilin e ka krijuar vetë, ku ka paraqitur të gjitha fotot e mallrave objekt prokurimi të shoqëruara secilën foto me përshkrim të veçantë. Përshkrimi i veçantë përmban tekstin e specifikimeve teknike të kopjuar nga shtojca 9 “Specifikimet teknike” të dokumentave standarte të tenderit.

Në këto kushte, vlerësojmë se nuk është paraqitur katalog ose skedë teknike për mallrat objekt prokurimi nga prodhuesit e deklaruar në autorizimin e distributorit “Safety Albania” sh.p.k dhe si rrjedhim nuk është e mundur të verifikohet pajtueshmëria e specifikimeve teknike të mallrave të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara nga AK.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “**Gentian Sadiku**” p.f, me NUIS L42314005A, me adresë: Rruga “Tom Plezha”, Pallati Milo, Nr 7, Yzberisht, Kashar, Tiranë dhe me ofertë 5.478.300 (pesë milion e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind) leke pa TVSH se është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Rruga “5 Maji”, Tiranë, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 24.09.2020.

Ankesa: Ka.

1.Në datë 25.08.2020 dhe ka marrë përgjigje në datë 27.08.2020

2.Në datë 30.09.2020 dhe ka marrë përgjigje në datë 05.10.2020